



Nr/Br.

133/20

Datë/Datum.

02.03.2020

PRISHTINË - PRISTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 133/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina- Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Prishtina REA”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e konsulencës në fushën e kulturës- ritender” me nr. prokurimit: 616-19-5523-322, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, më datë: 02.03.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. HEDHET, si e jashtë afatshme ankesa e operatorit ekonomik: “Prishtina REA”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e konsulencës në fushën e kulturës- ritender” me nr. prokurimit: 616-19-5523-322, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, pasi që e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 9 pika 9. 1- Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave.

II. I LEJOHET, autoritetit kontraktues– Komuna e Prishtinës, që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e konsulencës në fushën e kulturës- ritender” me nr. prokurimit: 616-19-5523-322, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, përkritazi me këtë ankesë (nëse nuk ka ankesë tjetër).

III. Pasi që ankesa e Operatorit Ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, për faktin se e njëjta është parashtruar tek autoriteti kontraktues jashtë afatit ligjor, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës.

IV. Obligohet, OE ankues që konform nenit 36 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Prishtina REA” Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 24.02.2020 me nr. 133/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e konsulencës në fushën e kulturës- ritender” me nr. prokurimit: 616-19-5523-322, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.03.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas analizimit dhe shoshitjes së provave dhe fakteve, shqyrtimit të dokumentacionit të lëndës, konstaton se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Letra standarde është dërguar me datën 03. 02. 2020. Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 06. 02. 2020. Vendimi i AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është publikuar me datën 10. 02. 2020

Pas shqyrtimit dhe analizimit paneli shqyrtues vlerëson se ankesa është e jashtëafatshme pasi që është parashtruar në OSHP jashtë afatit ligjor, në kundërshtim me nenin 9 pika 9. 1 të Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, ku thuhet: *“9.1 Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se”*.

Operatori ekonomik ankues e ka krijuar ankesën në sistemin e e-prokurimit me datën 13. 02. 2020 ndërkaj të njëjtën e ka dërguar në procedim me datën 24. 02. 2020, në sistemin e e-prokurimit, që i bie se

është parashtruar në ditën e katërbëdhjetë (14), andaj paneli shqyrtues duke i pasur të gjitha provat dhe faktet konstaton se ankesa e OE “Prishtina REA” është e jashtëafatshme.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK- KK Prishtinë

1x1 OE- “Prishtina Rea”

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.